

**VENDIM**  
**Nr.464, datë 18.7.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “EGNATIA-SHUSHICË” DHE MIRATIMIN E  
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET  
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 dhe 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Egnatia-Shushicë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 10 për qind të pikëve për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese për zgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Vëllezërit TOLA” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**